



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS

01.Nr.111-14198/2011

Kaçanik ; 28.10.2011

Në bazë të nenit 5 paragrafit (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr 03/L-68, Udhëzimit Administrativ Nr.3/2009 (Procedurat e zgjedhjes së drejtorit të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese si dhe nenit 58 pika (a) e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës shpall këtë;

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Drejtoria : Drejtoria për arsim dhe kulturë

Njësia : Shkolla fillore dhe e mesme e ultë „Emin Duraku” Kaçanik

Titulli i vendit të punës: I. DREJTOR dhe

II. zv. DREJTOR

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës -I koeficienti i pagës 7.8

II koeficienti i pagës 7.2

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të planifikojë, organizojë dhe të bashkërendis punën e përgjithshme në institucionin edukativo-arsimor dhe aftësues fillor dhe atë të mesëm të ultë,
- në bashkëpunim me DKA-në dhe me MASHT-in, , merr vendime të ndryshme që kanë të bëjnë me funksionimin e punës në Institucion.
- Kujdeset për mbarrëvajtjen e procesit mësimor , bashkëpunon me këshillin e shkollës, të prindërve dhe organe tjera që janë në interes të shkollës.
- Kryen edhe punë të tjera që përcaktohen me aktet administrative dhe planin e punës
- Në mungesë të drejtorit, Zv drejtori kryen të gjitha detyrat e cekura më lartë dhe detyrat e dhëna nga drejtori.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: sipas Udhëzimit administrativ Nr.3/2009 për procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese

Shkollimi i kërkuar , aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer njërin nga Fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve private të akredituara dhe të licencuar nga MASHT-i
- Të kenë më së paku tri vjet përvojë pune në arsim

Procedura e konkurrimit:- është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm dhe nëpunësit ekzistues

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin : - Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit administrativ Nr.03/2009 për procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese.

Kohëzgjatja e emërimit: emërimi në këtë pozitë është i caktuar dhe kontrata e punës për vendin e punës të theksuar më lartë është katër vjeçare.

Të interesuarit aplikacionit duhet ti bashkëngjisnin këto dokumente:

- Diplomën e Fakultetit të kryer, Dëshmi mbi përvojën e punës, Certifikatën e lindjes, CV-në sipas modelit të MASHT-it, Certifikatat e trajnimeve të zhvilluara, Programin zhvillimor të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese (më së shumti 5 faqe tekst me 30 rreshta të letrës të formatit A-4), Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore, Rekomandimin nga një person apo institucion publik-kredibil, Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve komunale.

Paraqitja e kërkesave- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në shërbimin e shkrimores –**Zyra e pranimit**, kati përdhes. Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë prej ditës së shpalljes së konkursit në mjetet e informimit. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afati nuk do të merren në shqyrtim.

Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes telefonit, tabelës së shpalljeve... **“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.**

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 mbi shërbimin civil të Republikës së Kosovës.”

Kryetari i Komunës
z.Xhabir Zharku